# Marsela Balili

GJYQTARE E GJYKATËS SË KRIMEVE TE RËNDA

Deklaratat e analizuara:

**13 Deklarata të analizuara**

(nga deklarimi Për Herë të Parë 2003 deri Periodik/Vjetor 2017)

## Ndryshimi i pasurisë nga fillimi i deklarimit deri në vitin 2017




Pasuria bruto nga fillimi I detyrës deri me datë 31.12.2017 është rritur 4.2 herë.

+ 1,101,250 Lekë Rritja mesatare vjetore e pasurisë

## Ndryshimi i pasurisë sipas kategorive

Vlera në Lekë







## Të ardhurat familjare të krijuara gjatë periudhës deklaruese

| Të Ardhurat 2004-2017 | Shuma në Lekë | Raporti në % |
|---|---|---|
| Të ardhura nga paga dhe shpërblime nga funksioni | 7,616,004 | 26.68% |
| Të ardhura nga pagat e bashkëshortit | 4,061,490 | 14.23% |
| Të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat | 626,188 | 2.19% |
| Kompensim I pagave nga Thesari I Shtetit | 9,024,440 | 31.62% |
| Të ardhura të prindërve të subjektit | 7,215,168 | 25.28% |
| Total | 28,543,290 | 100% |

## Kontrolli Aritmetik dhe Logjik

Kontrolli Aritmetik dhe Logjik për 12 vite rezultoi:

**3 Me Probleme**
**9 Pa Probleme**

Subjekti Marsela Balili në 3 vite rezulton me diferenca negative; në vitin 2010 në shumën 390,238 lekë; në vitin 2011 në shumën 390,665 lekë dhe në vitin 2015 në shumën 257,769 lekë. Në këtë analizë nuk janë përfshirë shpenzimet e konsumit familjar për familje.

Në vitin 2009 nuk janë deklaruar të ardhurat për bashkëshortin dhe në vitet në vazhdim deri në vitin 2016 mungojnë të ardhurat e deklarueses Marsela Balili dhe bashkëshortit të saj, si rezultat i pezullimit nga puna. Gjatë kësaj periudhe, subjekti deklaron se kanë përdorur të ardhura nga të afërmit si dhe nga puna informale, pa cilësuar llojin e punës dhe të ardhurat nga puna informale.

Në vitin 2014 subjekti merr dy hua prej 40,000 euro dhe 10,000 euro, të cilat nuk janë shlyer deri në fund të periudhës deklaruese 31.12.2017.

Deklaruesja Balili nga viti 2014 e në vazhdim ka përfaqësuar me prokurë dy prindërit që ndodhen në SHBA për të blerë një apartament në Vlorë; tërheqje e të ardhurave nga pensioni si dhe veprime në sistemin bankar me burim dërgesat nga puna e tyre.